

“BACHELOR” NË “GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE”

Emërtimi akademik i studimit	DIPLOMË UNIVERSITARE “BACHELOR” NË “GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE”
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	AKREDITUAR me Vendim nr.02, datë 10.01.2025
Cikli i studimit	Cikli i parë i studimeve “Bachelor” në “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej”; Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore; Njësia bazë e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë; institucion publik; i akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	3 (tre) vjet
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	a.Pranimi në këtë program studimi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe që plotëson kriterin e notës mesatare, të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. b. Në këtë program studimi, pranohen edhe ata kandidatë, të cilët kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, për të cilën kërkohet njehësimi nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. c.Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore (portali U-albania). <i>Përlllogaritja 50% nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore dhe 50% gruplëndët e përcaktuara nga fakulteti për disiplinat bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihet lënda).</i>

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit **“Bachelor” në “Gjuhë dhe letërsi shqipe”** është: të pajisë studentët me njohuritë e domosdoshme gjuhësore dhe letrare; me konceptet themelore bazë të çdo disipline; të njohë dhe të ruajë pasurinë kulturore, artistike, historike, që buron nga trashëgimia letrare, të ndihmojë në formimin shkencor, intelektual, estetik dhe kulturor të studentit. Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë, duke synuar që studentët në fund të ciklit të arrijnë:

1. Të kuptojnë dhe përkufizojë konceptet themelore gjuhësore dhe letrare.
2. Të analizojë kontekstet e përdorimit të kategorive gjuhësore e letrare dhe të vlerësojë se sa dhe si i shërbejnë ato ligjërit të tij.
3. Të marrë pjesë në diskutime brenda orës, duke shtruar pyetje. Të zhvillojë shkathtësi në përdorimin e koncepteve gjuhësore e letrare.
4. Të shkruajë e të komunikojë me shqipen standarde, të përvetësojë llojet e shkrimit letrar e profesional, të bëjë projekte e detyra kursi në lëndë të ndryshme.
5. Të përftojë aftësim praktik për kategoritë gjuhësore e zhanret letrare, natyrën dhe llojet e prozës rrëfimore, rrugët e jashtme dhe rrugët e brendshme të studimit të tekstit letrar etj.
6. Të analizojë në rrafsh kronologjik autorët më përfaqësues dhe veprat e tyre, të jetë në gjendje të sendërtojë veçoritë tipologjike të romantizmit dhe letërsisë së sotme shqipe dhe letërsisë së huaj.
7. Të jetë i përgatitur për perceptimin dhe përvetësimin e njohurive më të thelluara teorike dhe praktike në Gjuhë dhe Letërsi.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e mësuesit, gazetarit, redaktorit gjuhësor a letrar, kritikut, sekretarit.

Objektivat e përmendura më lart dhe aftësitë tjera, kërkuese, hulumtuese, krahasuese dhe interpretuese që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojë një performancë sa më të lartë në mjediset shkollore e në disa institucione të tjera, si: gazetar, as/sekretar, arkivist, redaktor gjuhësor e letrar, zëdhënës etj.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të tilla, si: gjuhësi, letërsi, gazetari, redaktim etj.

VEPRIMTARITË FORMUESE

1. **Lëndë bazë:** Hyrje në gjuhësi; Hyrje në shkencën e letërsisë; Shkrimi i shqipes (viti i parë). Dialektologji; Sociolinguistikë (viti i dytë). Gjuhësi teksti (viti i tretë). **Kredite 35 (tridhjetë e pesë).**
2. **Lëndë karakterizuese:** Letërsi e huaj I; Leksikologji; Fonetikë (viti i parë). Filozofi dhe estetikë; Pragmatistikë; Morfologji e gjuhës shqipe; Letërsi e huaj II (shek. XIX); Letërsi e vjetër shqipe + Rilindje; Letërsi moderne shqipe (viti i dytë). Histori në gjuhësinë botërore; Histori e gjuhës shqipe; Sintaksë; Letërsi e huaj III (shek.XX); Letërsi shqipe II (bashkëkohore)(viti i tretë).**Kredite 99 (nëntëdhjetë e nëntë).**
3. **Lëndë ndërdisiplinore/integruese:** Etnofolklor; Letërsi arbëreshe(viti i parë). Teori e letërsisë; Letërsi e krahasuar (viti i dytë).**Kredite 13 (trembëdhjetë).**
4. **Lëndë me zgjedhje:** Histori e albanologjisë; Dialektologji arbëreshe; Hartim dhe menaxhim projekti (disiplina gjuhësore).Teori komunikimi; Histori e qytetërimeve; Edukimi për median dhe informacionin për mësuesit e ardhshëm (disiplina letrare). **Kredite9 (nëntë).**
5. **Lëndë plotësuese:** Gjuhë dhe qytetërim i huaj(viti i parë). Praktikë në terren gjuhësore dhe folklorike(viti i tretë).**Kredite 18 (tetëmbëdhjetë).**
6. **Detyrime pëmbyllëse:** Provimi i përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome.**Kredite 6 (gjashtë).**

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm: 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	0 në 44 pikë
5 (pesë)	45 - 54 pikë
6 (gjashtë)	55 - 64pikë
7 (shtatë)	65 - 74 pikë
8 (tetë)	75 – 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma juaj e ciklit të parë “Bachelor” në “Gjuhë dhe Letërsishqipe” është urë lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula jonë e ndërtuar mbi konceptet bazë të mësimdhënies e mësimnxënies, sipas kornizës kurrikulare kombëtare, është konceptuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate të përshtatshme të të mësuarit, duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Prandaj, detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë që ky program studimi ofron.

Studenti i cili diplomohet në programin e studimit **“Bachelor”** në **“Gjuhë dhe Letërsi shqipe”**, mund të vazhdojë studimet në një program të ciklit të dytë **“Master i Shkencave”** në **“Mësuesi në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi”**, apo në një fushë të ngjashme. Bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia bazë e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit, mbarimi i këtij cikli jep mundësinë për vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë, në programet :

1. “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi”

Vetëm pas mbarimit të këtij cikli studimi, studentëve do t’u krijohen mundësitë për punësim më të sigurt dhe për studime të mëtejshme, duke avancuar dijet e tyre në aspekte teorike dhe praktike.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon mësues të formuar në fushën e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe, të kualifikuar me njohuri të tilla, si: Gramatikë, Drejtshkrim, Gjuhësi teksti, Letërsi shqipe, Letërsi e huaj etj. Për këtë arsye, synimi i programit të studimit “Bachelor” në “Gjuhë dhe Letërsi shqipe” është përgatitja e të diplomuarve, të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen në:

1. Shkolla të ndryshme 9-vjeçare.
2. Punonjës biblioteke.
3. Redaktorë gjuhësorë në institucione të ndryshme publike dhe jopublike.
4. Gazetarë në radio / televizion shtetëror apo privat.
5. Punonjës i akivave në institucione të ndryshme.
6. As / sekretar në institucione të ndryshme.
7. Drejtues guidash të ndryshme.

Studentët të cilët përfundojnë programin e studimit “Bachelor” në “Gjuhë dhe Letërsi shqipe” fitojnë njohuri në: Gramatikë, Drejtshkrim, Gjuhësi teksti, Histori gjuhe, Letërsi shqipe, Letërsi e huaj, Etnofolklor etj.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithsej	Semestri
Viti i parë				
1.	Hyrje në gjuhësi	6	150	I
2.	Hyrje në shkencën e letërsisë	6	150	I
3.	Shkrimi i shqipes	8	200	I + II
4.	Letërsi e huaj I	8	200	I + II
5.	Leksikologji	7	175	II
6.	Fonetikë	6	150	II
7.	Etnofolklor	4	100	I
8.	Letërsi arbëreshe	3	75	II
9.	Gjuhë dhe qytetërim i huaj	12	300	I + II
Gjithsej viti i parë		60 ECTS	1500 orë	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithsej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Dialektologji	5	125	I
2.	Sociolinguistikë	5	125	II
3.	Filozofi dhe estetikë	8	200	I + II
4.	Pragmatistikë	5	125	I
5.	Morfologji e gjuhës shqipe	8	200	I
6.	Letërsi e huaj II (shek. XIX)	8	200	II
7.	Letërsi e vjetër shqipe + Rilindje	8	200	I

8.	Letërsi moderne shqipe	7	175	II
9.	Teori e letërsisë	3	75	II
10.	Letërsi e krahasuar	3	75	II
Gjithsej viti i dytë		60 ECTS	1500 orë	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithsej	Semestri
Viti i tretë				
1.	Gjuhësi teksti	5	125	II
2.	Histori në gjuhësinë botërore	6	150	I
3.	Histori e gjuhës shqipe	5	125	II
4.	Sintaksë	7	175	I
5.	Letërsi e huaj III (shek. XX)	8	200	I
6.	Letërsi shqipe II (bashkëkohore)	8	200	II
Lëndë me zgjedhje gjuhësore dhe letrare				
7.	• Histori e albanologjisë	5	125	I
	• Dialektologji arbëreshe			
	• Hartim dhe menaxhim projekti (disiplina gjuhësore)			
8.	▪ Teori komunikimi	4	100	II
	▪ Histori e qytetërimeve			
	▪ Edukimi për median dhe informacionin për mësuesit e ardhshëm			
9.	Praktikë në terren gjuhësore dhe folklorike	6	150	II
10.	Provimi i përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome	6	150	II
Gjithsej viti i tretë		60 ECTS	1500 orë	
Total: viti I + viti II + viti III		180 ECTS	4500 orë	